Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-028/04 - 0061103/26 **dt.** 19.10.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 25 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me Vendimin Nr.Prot.1459/26, dt. 19.08.2026, si dhe Kërkesën elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 08.10.2026, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M
(Për Emërimin e Koordinatorit të Planit të Integritetit)

1. **Emërohet** znj. Teuta Selmani Pllana - Zyrtare Ligjore në Drejtorinë për Siguri dhe Emergjenca, si Koordinatore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit të Integritetit.

2. Detyrat kryesore të Koordinatores të emëruar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi janë:

2.1. Organizon dhe koordinon punën e grupit punues;
2.2. Siguron komunikimin ndërmjet njësive organizative gjatë procesit të identifikimit të rreziqeve;
2.3. Mbledhë dhe sistematizon informacionet dhe dokumentacionin relevant;
2.4. Mbikëqyrë procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të integritetit;
2.5. Përgatit draftin e Planit të Integritetit në bashkëpunim me grupin punues;
2.6. Koordinon procesin e konsultimit draftit planit;
2.7. Mbështet procesin e monitorimit dhe raportimit të zbatimit të planit.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS * OPŠTINA MITROVICA * REPUBLIKA KOSOVA

Shtojcë:
Email-i nga Zyra e Kryetarit, dt. 08.10.2026.
T'i dërgohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
1x1 Anëtarëve të ardhshëm të Grupit Punues
1x1 Arkivit